



FKEE

FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË
KOSOVSKI FOND ZA ENERGETSKU EFIKASNOST
KOSOVO ENERGY EFFICIENCY FUND

Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë

Ri-Shpallje për vend të lirë pune

Pozita:	Këshilltar i Lartë Ekonomik dhe Financiar
Organizata:	Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE)
Lokacioni:	Prishtinë (Republika e Kosovës)
Data e shpalljes së konkursit:	16.02.2021
Data/ora e mbylljes:	19.03.2021, 16:00 (koha lokale)
Lloji dhe kohëzgjatja e kontratës:	Kontratë pune me orar të plotë për një periudhë të caktuar kohore (3 vjet) me mundësi vazhdimi
Periudha provuese:	3 muaj
Kur pritët të fillojë marrëdhënia e punës:	Brenda dy javësh pas nënshkrimit të kontratës së punës dhe jo më vonë se 01.05.2021 (cilado datë të jetë e para)

A) Rrethanat organizative

Me miratimin e Ligjit Nr. 06/L-079 për Eficiencë të Energjisë (LEE), Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE) është themeluar si entitet i pavarur, autonom dhe i qëndrueshëm, në mbështetje të objektivave të politikës për Eficiencë të Energjisë së Republikës së Kosovës, duke promovuar, mbështetur dhe zbatuar masat e eficiencës së energjisë, si dhe duke tërhequr dhe menaxhuar burimet financiare në mënyrë që të financojë dhe zbatojë projekte investimesh në fushën e Eficiencës së Energjisë në një mënyrë të qëndrueshme.

Këshilltari i Lartë Ekonomik dhe Financiar emërohet nga Drejtori Menaxhues i FKEE për një mandat që nuk i kalon tre (3) vjet, me një mundësi të riemërimit. Ai / ajo raporton te Drejtori Menaxhues i FKEE.

B) Roli dhe përgjegjësitë kryesore

Nën mbikëqyrjen e Drejtorit Menaxhues, Këshilltari i Lartë Ekonomik dhe Financiar është përgjegjës për ekzekutimin me cilësi të lartë dhe të koordinuar të detyrave / aktiviteteve të besuara atij / saj nga Drejtori Menaxhues dhe shpërndarjen e rezultateve që kanë të bëjnë me këto detyra / aktivitete në kohë. Këshilltari i Lartë Ekonomik dhe Financiar është përgjegjës për përkthimin e njohurive dhe përvojave në fushën e Këshillimit për FKEE në përputhje me standardet, normat e vlefshme dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare.

C) Detyrat dhe funksionet specifike si dhe rezultatet e pritshme kryesore

Këshilltari i Lartë Ekonomik dhe Financiar është përgjegjës për sa vijon:

- Vlerësimin e propozimeve të pranuar të projekteve nga këndvështrimi ekonomik dhe financiar dhe përgatitjen e raporteve të vlerësimit për përpunim të mëtejshëm nga FKEE-ja;
- Kontributet për zhvillimin e thirrjeve (p.sh. përshtatshmëria, kriteret teknike etj.);
- Veprimin si Menaxher i Projektit në projektet EE dhe BRE të mbështetura nga FKEE-ja, me detyrim që të ndjekë projektin nga nënshkrimi i Marrëveshjes për Inicimin e Projektit, gjatë zbatimit, mbikëqyrjes dhe deri në komisionim;
- Pjesëmarrjen në Komisionin Teknik si dhe në Komisionet e Vlerësimit për Tenderët;
- Ofrimin e përkrahjes teknike për FKEE-në në çdo çështje teknike që kërkon një profil të një eksperti ekonomik dhe/ose financiar.

D) Kualifikimet, përvoja dhe aftësitë gjuhësore

- Ka përvojë profesionale në Ekonomi dhe/ose Financa ose ekuivalent me nivelin e arritur të arsimit që korrespondon me nivelin VI/1 në Shtojcën 4 të rregullores për shpërblimin e personelit të FKEE (programi i arsimit të lartë, programi më i lartë profesional; për kandidatët e diplomuar jashtë Kosovës, duhet të sigurohet prova e njohjes së diplomës në Kosovë;
- Pesë (5) vjet përvojë pune të përgjithshme profesionale, nga të cilat të paktën tre (3) vjet në detyra / aktivitete relevante, mundësisht si Këshilltar në Ekonomi dhe/ose Financa;
- Njohuri të shkëlqyeshme për të paktën një nga gjuhët zyrtare në Kosovë dhe gjuhën angleze;
- Posedimi i shkathtësisë informatike në Aplikacionet MS (Word, Excel, PowerPoint, etj.);
- Nuk është dënuar me aktgjykim të formës së prerë për një vepër penale për të cilën dënimi maksimal tejkalon gjashtë (6) muaj burgim dhe dënimi nuk është i kushtëzuar; (evidencat nuk duhet të jenë më të vjetra se data e shpalljes së vendit të punës të këtij njoftimi për vend të lirë të punës).

E) Shpërblimi

Shpërblimi bëhet sipas pakos konkurruese në përputhje me Rregulloren e Brendshme për Shpërblimin e Personelit të FKEE (R-OBPSH).

1. Përmbajtja e dokumenteve të aplikimit

Dokumentet e aplikimit duhet të përmbajnë së paku:

- 1) CV-në e hollësishme të aplikuesit
- 2) Kopje të diplomës (diplomave) për studimet e mbaruara universitare, përfshirë dëshminë e njohjes së diplomës (nëse aplikohet)
- 3) Kopje të dëshmisë se nuk ka qenë i dënuar (shiko kushtet e hollësishme në Seksionin D më lart)
- 4) Letrën e motivimit përfshirë vizionin e aplikuesit për punën e Këshilltarit të Lartë Ekonomik dhe Financiar gjatë kohës së mandatit (jo më shumë se 5 (pesë) faqe).

Dokumentet e aplikimit mund të përgatiten në secilën prej tre (3) gjuhëve: shqip, serbisht ose anglisht. Kopjet e çfarëdo dëshmie që tregon për kualifikimet, përvojën dhe aftësitë gjuhësore të aplikuesve janë të mirëseardhura.

2. Dorëzimi i aplikacioneve

Aplikimet, përfshirë të gjitha dokumentet e kërkuara, dorëzohen në info@fkee-rks.net deri më **19 Mars 2021, ora 16.00.**

Aplikacionet që nuk i kanë të gjitha dokumentet e parapara (1-4 më lart) nuk do të merren parasysh nga komisioni vlerësues.